



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

PROJEKTLIGJ “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”

Raport për rezultatet e konsultimit publik

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimet në portalin e regjistrimit elektronik: 20 ditë pune.

Konsultimet duke përfshirë dhe tryezat e realizuara kanë zgjatur nga muaji Qershor i vitit 2022 deri në muajin Mars të vitit 2023.

Shënim: Sqarojmë se për sa i përket përmbajtjes së projektligjit, ne thelb nuk ka ndryshuar nga momenti në të cilin është publikuar për konsultim publik. Ndryshimet që janë realizuar konsistojnë në renditjen e dispozitave dhe në riformulimin e tyre, sa i përket teknikës legislative.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit publik të përdorura si vijon:

- a. Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 15.06.2022 - 13.07.2022 , gjatë së cilës janë përcjellë komente përmes këtij protali.
- b. Tryezat konsultative me grupet e interesit

Aktivitetet e realizuara:

Maj 2023 - identifikimi i grupeve të interesit, përzgjedhja e metodave të konsultimit, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit.

15.06.2022 - 13.07.2022 - Projektligji, në zbatim të ligjit 146/2014, i nënshtrohet procesit të konsultimit në portalin e “Regjistrit elektronik për Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike”

Projektligji, relacioni shpjegues, si dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet adresës së e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Më datë 12.07.2023 janë organizuar dy takime konsultative nga Ministria e Drejtësisë me përfaqësues nga institucione të administratës publike dhe komuniteti i biznesit.

4. Palët e interesit të përfshira

Hartimi i projektligjit ka nisur pas përcjelljes së draftit të projektligjit në Ministrinë e Drejtësisë nga ana e Zyrës së Komisionerit. Më tej, është vijuar me hartimin e projektligjit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e teknikës legjislative. Procesi i hartimit të këtij projektligji ka kaluar përmes disa ndryshimeve me qëllim reflektimin e komenteve të aktorëve të përfshirë në procesin e konsultimit publik, përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe parashikimet e tjera ligjore, si dhe në përputhje me komentet e përcjella nga Komisioni Evropian. Gjatë hartimit të projektligjit, palët e interesit të cilat kanë qenë pjesëmarrës me qëllim përcjelljen e kontributeve të tyre, ishin përfaqësues nga Shoqëria Civile, Institucionet e pavarura, Institucionet shtetërore, Partneret për Zhvillim dhe KE.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

<p>Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i></p>	<p>Komenti <i>(grumbulloni dhe përmblihdni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i></p>	<p>Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i></p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
<p>Koment që lidhet me përmbajtjen tërësore të ligjit.</p>	<p>Zëvendësimi i termit “individ” me “person fizik” sipas terminologjisë së përdorur nga Kodi Civil. Ky koment është pranuar.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	
<p>Koment që lidhet me përmbajtjen tërësore të ligjit.</p>	<p>Zëvendësimi i togfjalëshit “mjete automatike” me “mjete të automatizuara dhe elektronike”.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Ky koment nuk është pranuar duke qenë se termi “mjete automatike” përdoret edhe nga ligji në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe është një term i pranuar në praktikë dhe që nuk ka paraqitur ndonjë problematikë në kuptim. Për më tepër, ky term është i njëjtë me termin e parashikuar nga GDPR.</p>

<p>Neni 2 pika 3 e projektligjit.</p> <p>2. Ky ligj zbatohet gjithashtu për përpunimin e të dhënave personale nga kontrollues ose përpunues që nuk janë të vendosur në Shqipëri, por ku ligji shqiptar zbatohet në bazë të së drejtës ndërkombëtare publike.</p>	<p><i>“Në pikën 2, të nenit 3, të realizohet një përafrim i plotë me Rregulloren dhe të zbatohet përjashtimi i fushë-zbatimit të këtij ligji edhe ndaj përpunimit të të dhënave personale nga ana e autoriteteve shtetërore, në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, në fushën e politikës së përbashkët të sigurisë.”</i></p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Në lidhje me këtë koment sjellim në vëmendje se GDPR parashikon se nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose ekzekutimit të dënimeve penale, për shkak se kjo fushë rregullohet nga Direktiva e Policisë. Ndërkohë, projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale synon që të përafrojë në një akt të vetëm, si GDPR ashtu edhe Direktivën e Policisë. Në këto kushte, komenti nuk mund të reflektohet për shkak se përpunimi i të dhënave personale nga autoritetet kompetente rregullohet nga Pjesa III e tij.</p>
<p>Koment që lidhet me përmbajtjen tërësore të ligjit.</p>	<p><i>“Duke qenë se projektligji ka përcaktuar në dispozita konkrete edhe terma të rinj për lexuesin, siç janë koncepti i mbrojtjes së të dhënave në projektim (by design) dhe mbrojtjes në mënyrë të paracaktuar (by default), sugjerojmë që këto koncepte të pasqyrohen nëpërmjet një shpjegimi në seksionin e ‘përkufizimeve’.”</i></p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Projektligji përmban dispozitat e përafuara me GDPR, e cila në vetvete nuk parashikon ndonjë përkufizim për këto terma, pavarësisht se ato janë koncepte të reja edhe për lexuesin në Bashkimin Europian. Në GDPR ky term përdoret për shkak të shtrirjes së fushës së zbatimit të saj në disa vende të BE, në kuadër të mekanizmit të bashkëpunimit dhe konsistencës së parashikuar në Kreun VII të GDPR. Në kushte kur ky kre nuk</p>

				është përafuar pasi i dedikohet vendeve anëtare të BE, termi “seli kryesore” nuk është përmendur në ligj dhe si pasojë nuk është nevoja që të përkufizohet.
Neni 5 – mbi përkufizimet	<i>“Në nenin 5, mungon përkufizimi në lidhje me “selinë kryesore” të një kontrolluesi ose përpunuesi.”</i>	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Refuzuar	Sillet në vëmendje se në GDPR ky term përdoret për shkak të shtrirjes së fushës së zbatimit të saj në disa vende të BE, në kuadër të mekanizmit të bashkëpunimit dhe konsistencës së parashikuar në Kreun VII të GDPR. Në kushte kur ky kre nuk është përafuar pasi i dedikohet vendeve anëtare të BE, termi “seli kryesore” nuk është përmendur në ligj dhe si pasojë nuk është nevoja që të përkufizohet.
Neni 5 – mbi përkufizimet	Mbi termin ‘marrës’, sugjerohet shtesa e citimit të drejtpërdrejtë të Rregullores GDPR: <i>“Megjithatë, autoritetet publike që mund të administrojnë ose të njihen me të dhëna personale në kuadrin e një procedimi penal/hetimi të caktuar në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar dhe kuadrin ligjor në fuqi në Shqipëri, nuk do të konsiderohen si marrës; përpunimi i këtyre të dhënave nga</i>	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Refuzuar	Komenti nuk është reflektuar pasi parashikimi i GDPR në këtë pjesë të përkufizimit të termit “marrës” lidhet me faktin se GDPR parashikon se nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose ekzekutimit të dënimeve penale, për shkak se kjo fushë rregullohet nga Direktiva e Policisë. Ndërkohë, projektligji për mbrojtjen e të dhënave

	<i>këto autoritete publike duhet të jetë në përputhje me rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave sipas qëllimeve të përpunimit’, një shtesë kjo në përputhje me nenin 4, pika 9 të Rregullores.”</i>			personale synohet që të përafrojnë në një akt të vetëm, si GDPR ashtu edhe Direktivën e Policisë. Në këto kushte, komenti nuk mund të reflektohet për shkak se përpunimi i të dhënave personale nga autoritetet kompetente, përfshirë si marrës, rregullohet nga Pjesa III e tij.
Neni 5 – mbi përkufizimet	Në pjesën e përkufizimeve të shtohet edhe termi ‘ <i>përfaqësues/e ligjor/e</i> ’, i cili nënkupton një person fizik ose juridik i vendosur në Shqipëri, i/e cili/a e caktuar nga kontrolluesi ose përpunuesi me shkrim, përfaqëson kontrolluesin ose përpunuesin në lidhje me detyrimet e tyre përkatëse, sipas këtij ligji.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Pranuar	Sa i përket këtij komenti sqarojmë se përkufizimi i përfaqësuesit është dhënë në shkronjën “k” të nenit 5.
Neni 5 – mbi përkufizimet	<i>“Për gërmën “dh”, të nenit 5 të projektligjit, mendojmë që për detyrat e hartuara nën kompetencë të Komisionerit, të realizohet shtesa se këto detyra duhet të jenë rigorozisht në përputhje dhe në zbatim të mirë të ligjit.”</i>	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Refuzuar	Në lidhje me këtë koment theksojmë se jo vetëm për kodet e sjelljes, detyrat duhet të zbatohen në përputhje me ligjin, në të kundërt çdo person përgjegjës do të mbajë përgjegjësi për pasojat nga shkelja e ligjit. Në këtë kuptim, nuk vlerësohet e nevojshme që të shtohet togfjalëshi i propozuar.

<p>Neni 6, pika 1, shkronja “a”</p> <p>a) përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente kundrejt subjektit të të dhënave (“parimi i ligjshmërisë”);</p>	<p>Sugjerohet që fjalët ‘kundrejt subjektit të të dhënave (parimi i ligjshmërisë)’ duhet të hiqen, sepse vetë përpunimi kërkon zbatimin e ligjit (kërkesat e ligjit), ndërsa shprehja ‘parimi i ligjshmërisë’ është një nocion më i gjerë.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Komenti është pranuar dhe dispozita është riformuluar në përputhje me parashikimin e GDPR.</p>
<p>Neni 6, pika 1, shkronja “b”</p> <p>b) mbledhen për një qëllim specifik dhe legjitim, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes, dhe nuk përpunohen më tej për një qëllim tjetër që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar, përveç nëse përpunimi i mëtejshëm parashikohet me ligj të veçantë, për shkak të interesit publik, ose të drejtave dhe lirive të të tjerëve, duke respektuar thelbin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe në atë masë që është e nevojshme dhe proporcionale për realizimin e interesit, ose, nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij</p>	<p>KSHH sugjeron zëvendësimin e togfjalëshit “ose të të drejtave dhe lirive të të tjerëve”, me atë “për qëllime kërkimore shkencore, historike ose qëllime statistikore”. Mbetet e paqartë, cili është kuadri dhe referenca ligjore që parashikon realizimin e përpunimit të të dhënave personale të një individi, për shkak të të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Gjithashtu, referuar gërmës “d” të po së njëjtës dispozitë, KSHH vlerëson se edhe ky veprim duhet të realizohet me pëlqimin e subjektit, është fjala për të dhënat që mendohet (pretendohet) se mund të mos jenë të sakta dhe të plota.”</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Në lidhje me këtë koment sqarojmë se togfjalëshi i referohet përpunimit të të dhënave personale për një qëllim specifik dhe të ligjshëm, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes, dhe nuk përpunohen më tej për një qëllim tjetër që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar, me përjashtim të rastit kur përpunimi i mëtejshëm parashikohet me ligj të veçantë, për shkak të interesit publik, ose të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Raste të tilla janë ato të parashikuara nga Pjesa e III e këtij ligji. Sa i përket komentit për shkronjën “d” sjellim në vëmendje se ajo është formuluar në përputhje me GDPR.</p>

<p>(“parimi i përpunimit në përputhje me qëllimin”);</p>				
<p>Neni 7, shkronja “a”; Shtimi i dispozitave në nenin 7</p>	<p>KSHH sugjeron shtimin e togfjalëshit ‘për përpunimin e të dhënave të tij/saj personale për një ose më shumë qëllime specifike’ në mënyrë që të ketë një qartësi logjike të përmbajtjes së dispozitës respektive. Gjithashtu, në këtë dispozitë sugjerojmë që të shtohet edhe një tjetër gjermë, e cila të parashikojë në përputhje me përmbajtjen e Rregullores:</p> <p>“Kur përpunimi për një qëllim tjetër nga ai për të cilin janë mbledhur të dhënat personale nuk bazohet në pëlqimin e subjektit të të dhënave ose në një ligj të vendit tone që përbën një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike, kontrolluesi, për të konstatuar nëse përpunimi për një qëllim tjetër është në përputhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur fillimisht të dhënat personale, merr parasysh,</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Sa i përket këtij komenti sjellim në vëmendje se dispozita ka qartësi logjike pasi ajo duhet të lexohet së bashku me përkufizimin e termit “pëlqim” ku është përcaktuar dhënia e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale për një ose më shumë qëllime specifike. Megjithatë, komenti është pranuar dhe dispozita është reflektuar në përputhje me GDPR dhe komentet e Komisionit Evropian.</p>

	<p>ndër të tjera: a) çdo lidhje ndërmjet qëllimeve për të cilat janë mbledhur të dhënat personale dhe qëllimeve të përpunimit të mëtejshëm të synuar; b) kontekstin në të cilin janë mbledhur të dhënat personale, veçanërisht në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet subjekteve të të dhënave dhe kontrolluesit; c) natyrën e të dhënave personale, në veçanti nëse përpunohen kategori të veçanta të të dhënave personale, në përputhje me nenin 9, ose nëse përpunohen të dhënat personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale, në përputhje me nenin 10; ç) pasojat e mundshme të përpunimit të mëtejshëm të synuar për subjektet e të dhënave; d) ekzistenca e masave mbrojtëse të përshtatshme, të cilat mund të përfshijnë enkriptim ose pseudonimizim”.</p>			
<p>Neni 9 - Përpunimi i ligjshëm i të dhënave sensitive</p> <p>1. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafin 2 të</p>	<p>“Për nenin 9 të projektligjit, KSHH vlerëson se shprehja ‘mendimet politike’ mund të zëvendësohet me shprehjen ‘bindjet politike’. Paragrafi 1) përjashton rastet e</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Sa i përket këtyre komenteve sqarojmë se janë kryer disa ndryshime me qëllim qartësinë e normës dhe përputhshmërinë me GDPR.</p>

<p>këtij neni, ndalohej përpunimi i të dhënave që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, përpunimi i të dhënave gjenetike ose të dhënave biometrike me qëllim për të identifikuar në mënyrë unike një person, si dhe i të dhënave në lidhje me shëndetin, jetën ose orientimin seksual të një personi.</p> <p>2. Me kusht që të zbatohen masa të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të subjekteve të të dhënave, lejohet përpunimi i të dhënave sensitive në rastet kur:</p> <p>a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij të qartë, përveç kur parashikohet me ligj të veçantë që ndalimi i përpunimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të derogohet me anë të pëlqimit nga subjekti i të dhënave;</p> <p>b) përpunimi i të dhënave është i nevojshëm për përmbushjen e</p>	<p>paragrafit të dytë, që lejon përpunimin e të dhënave sensitive. Kemi mendimin se kjo çështje duhet të bëhet më e qartë, sepse në këtë drejtim mund të ketë tejkalime dhe abuzime në kërkesat për të dhënë pëlqimin.”</p> <p>Sa i përket paragrafit d), mendojmë se duhet të bëhet më e qartë. Kjo edhe për faktin se kjo kërkesë ka të bëjë me organizatat jofitimprurëse politike, filozofike dhe sidomos fetare.</p> <p>Për paragrafin 2), gërma f), mendojmë se edhe ky formulim duhet të qartësohet, sepse ka çështje të papërfunduara që nuk duhet të bëhen publike (në këtë këndvështrim duhet të mbahet në konsideratë praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut). Ndërkohë për gërmën h) të së njëjtës dispozitë, duhet të qartësohet se ç’duhet kuptuar me shprehjen ‘parandaluese’. Kjo terminologji mendojmë që të qartësohet, që të mos ketë interpretime të ndryshme.”</p>			
---	--	--	--	--

<p>një detyrimi ose të drejte specifike të kontrolluesit ose të subjektit të të dhënave në fushën e punësimit ose sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale, duke përfshirë detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga një marrëveshje kolektive, në përputhje me dispozitat ligjore në këto fusha;</p> <p>c) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetikë të subjektit të të dhënave dhe ky i fundit është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e tij, si dhe, në rastet kur është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetikë të një personi tjetër;</p> <p>d) është i nevojshëm për veprimtarinë e ligjshme të organizatave jofitimprurëse politike, filozofike, fetare dhe sindikaliste, me kusht që përpunimi të lidhet vetëm me anëtarët ose ish-anëtarët e organizatës ose me persona që kanë kontakte të rregullta me të në kuadër të veprimtarisë së saj,</p>				
---	--	--	--	--

<p>si dhe që të dhënat personale të mos përhapen jashtë organizatës pa pëlqimin e subjekteve të të dhënave;</p> <p>e) lidhet me të dhëna që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave dhe përpunimi është i nevojshëm për realizimin e një interesi të ligjshëm;</p> <p>f) është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e një pretendimi ligjor përpara gjykatave ose organeve administrative;</p> <p>g) është i nevojshëm për një interes thelbësor publik dhe parashikohet me ligj të posaçëm i cili është proporcional me qëllimin e ndjekur dhe respekton thelbin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave;</p> <p>h) është i nevojshëm për qëllime të mjekësisë parandaluese ose në kuadër të dëmeve të shëndetit në punë, për vlerësimin e aftësisë për punë të punonjësit, për diagnostikimin mjekësor, për ofrimin, trajtimin ose menaxhimin e shërbimeve</p>				
---	--	--	--	--

<p>shëndetësore ose të kujdesit shëndetësor sipas ligjit ose në zbatim të një kontrate me një profesionist të kujdesit shëndetësor dhe me kusht që personat që ofrojnë këto shërbime t'i nënshtrohen sekretit profesional ose të veprojnë nën përgjegjësinë e një profesionisti, i cili i nënshtrohet sekretit profesional;</p> <p>i) është i nevojshëm për arsye të interesit publik në fushën e shëndetit publik, si mbrojtja nga kërcënimet serioze ndërkufitare për shëndetin ose garantimi i standardeve të larta të cilësisë dhe sigurisë së kujdesit shëndetësor dhe produkteve ose pajisjeve mjekësore, sipas një ligji që garanton masa të përshtatshme mbrojtëse, në veçanti, detyrimin për ruajtjen e sekretit profesional të personave që përpunojnë të dhënat personale;</p> <p>j) është i nevojshëm për qëllime arkivimi për interes publik, për qëllime historike, kërkimore</p>				
---	--	--	--	--

shkencore ose qëllime statistikore, në përputhje me nenin 16.				
Mbi titullin e nenit 10; Shtimi i një dispozite të posaçme sa i përket “përpunimit i cili nuk kërkon identifikim”	Sipas KSHH, neni 10 duhet të titullohet ‘Përpunimi i ligjshëm i të dhënave në lidhje me dënimet dhe veprat penale’, ndërkohë që duhet të parashikohet në përputhje me Rregulloren GDPR edhe një tjetër dispozitë e posaçme sa i përket ‘përpunimit i cili nuk kërkon identifikim’.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Pranuar	Sa i përket këtij komenti, sqarojmë se janë kryer ndryshimet e nevojshme dhe është shtuar neni 11, sipas GDPR.
Neni 11, pika 2 2. Vendimet e gjykatave, si dhe vendimet e organeve administrative të një shteti të huaj, që përcaktojnë detyrimin për një kontrollues ose përpunues të transferojë ose përhapë të dhëna personale, mund të njihen ose zbatohen vetëm nëse bazohen në një marrëveshje ndërkombëtare, siç mund të jetë një traktat për ndihmë të ndërsjelltë juridike, në	KSHH vlerëson se pas togfjalëshit ‘pa cënuar’ të shtohet edhe fjala ‘e paragjykuar’ kriteret e tjera për transferim të parashikuara në këtë seksion.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Refuzuar	Ky koment nuk është reflektuar pasi termi “prejudice” i përdorur nga GDPR mund të përkthehet në mënyrën më të përshtatshme përmes termit “cenuar” pasi kështu arrihet që në çdo rast të garantohet zbatueshmëria e kriterëve të tjera për transferim.

<p>fuqi midis shtetit të huaj kërkues dhe Republikës së Shqipërisë, pa cenuar kriteret e tjera për transferim të parashikuara në këtë Seksion.</p>				
<p>Shtim i dispozitave në nenin 12, pika 3</p> <p>3. Komisioneri monitoron zhvillimet në ato shtete ose organizata ndërkombëtare, të cilat janë vlerësuar me nivel të mjaftueshëm në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe rishikon vendimet e tij në përputhje me rrethanat.</p>	<p>Në pikën 3, të nenit 12 të KSHH vlerëson të shtohet dispozita: “Kur Komisioneri, ne administrim te informacionit te domosdoshem, konstaton se një vend i tretë, një territor ose një ose më shumë sektorë të specifikuar brenda një vendi të tretë, ose një organizatë ndërkombëtare nuk siguron më një nivel te mbrojtjes në kuptim të paragrafit 2 të këtij neni, për aq sa është e nevojshme, shfuqizon, ndryshon ose pezullon vendimin e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni me akte zbatuese pa efekt prapaveprues. Komisioneri do të hyjë në konsultime me vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare me synimin për të korrigjuar situatën që shkakton vendimin e marrë në përputhje me paragrafin e mesiperm. Komisioneri do te publikoje në</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Sa i përket këtij komenti vlerësojmë se ai nuk mund të reflektohet pasi është një detyrë të cilën GDPR ia ka ngarkuar Komisionit European dhe jo autoriteteve mbikëqyrëse. Gjithashtu, në kushtet e Shqipërisë dhe kapaciteteve të Komisionerit, nuk është e mundur zbatimi i një detyrimi të tillë nëse vendoset në ligj. Megjithatë, përsa kohë Komisioneri do të monitorojë situatën në vendet e tjera, si dhe praktikën e vetë institucionit, ai do të jetë në gjendje që të kryejë detyrën e tij duke rishikuar vendimet përkatëse.</p>

	faqen e tij të internetit një listë të vendeve të treta, territoreve dhe sektorëve të specifikuar brenda një vendi të tretë dhe organizatave ndërkombëtare për të cilat ka vendosur që një nivel adekuat mbrojtjeje është ose nuk është siguruar”.			
<p>Neni 14, pika 1, shkronja “a”</p> <p>1. Komisioneri mund të miratojë rregulla të detyrueshme për korporatat, të cilat përcaktojnë rregulla për përpunimin e të dhënave personale brenda një grupi ndërmarrjesh të përfshira në veprimtari të përbashkëta ekonomike, nëse këto rregulla përmbushin kërkesat e mëposhtme:</p> <p>a) janë të detyrueshme dhe zbatohen nga çdo anëtar i grupit të ndërmarrjeve, përfshirë punonjësit e tyre;</p>	<p>KSHH ka sugjeruar edhe shtesën “të përfshira në një aktivitet të përbashkët ekonomik”, në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 14, me qëllim qartësimin e unitetit të ndërmarrjeve që janë pjesë e të njëjtës korporatë. Një terminologji e tillë është e përdorur edhe nga neni 47, pika 1, gërma “a” e Rregullores GDPR. Për po të njëjtin nen, KSHH sugjeron që në pikën 2, të shtohet edhe përcaktimi “në rregullat e detyrueshme të korporatave, edhe të procedurave që duhet të ndiqen për ankimet.”</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Ky koment është pranuar dhe dispozita është riformuluar në përputhje me GDPR.</p>

<p>Neni 15 - Përpunimi i të dhënave personale dhe liria e shprehjes</p>	<p>Në nenin 15, pika 1, gërma c) duhet të parashikohet si një kusht për zbatimin e përjashtimeve nga kjo dispozitë: “c) të respektojnë thelbin e të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe lirinë e shprehjes”.</p> <p>Për pikën 2) të së njëjtës dispozitë, thuhet se “pavarësisht nga mënyra që përdoret për t’i transmetuar ato”, mendojmë se mënyrat e përdorura nuk duhet të çenojnë dinjitetin, personalitetin dhe privatësinë e personit.</p> <p>Për pikën 3) të së njëjtës dispozitë, kemi mendimin se kjo duhet të pasqyrohet në ligje dhe jo në akt nënligjor të Komisionerit.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Në lidhje me këto komente, sqarojmë se dispozita është riformuluar në përputhje me parashikimet e GDPR.</p>
<p>Neni 17 - Përpunimi i të dhënave personale dhe aksesit i informacionit në sektorin publik</p> <p>1. E drejta për mbrojtjen e të dhënave të individëve nuk cenon të drejtën e aksesit të publikut në dokumente zyrtare, të mbajtura nga një autoritet ose organ publik ose një subjekt privat për</p>	<p>KSHH përcjell komentit se duhet të përfshihet edhe e drejta e respektimit të parimit të privatësisë, si dhe të bëhen më të qarta rasti ose rastet e fitimit të aksesit në dokumentat zyrtare ose në informacionin publik.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Për këtë koment sqarojmë se çështjet e ngritura në të janë të rregulluara nga ky ligj për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar për çështjet që lidhen me të drejtën e informimit dhe aksesit në informacionin/dokumentacionin publik, si dhe dispozita është riformuluar në</p>

<p>kryerjen e një funksioni me interes publik, si dhe aksesin e publikut në informacione për një individ, që kanë lidhje me kryerjen e funksioneve dhe detyrave zyrtare, në përputhje me nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve të jashtëzakonshme kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e jetës ose e drejta e integritetit fizik dhe mendor, kërkojnë mbrojtje të të dhënave të individëve, për një rast specifik ose kategori specifike rastesh.</p> <p>2. E drejta për mbrojtjen e të dhënave të personave të tjerë, të ndryshëm nga ata të përmendur në paragrafin 1, respektohet sipas ligjit, kur jepet ose fitohet akses në dokumente zyrtare ose në informacion publik.</p>				<p>përputhje me GDPR dhe komentet e Komisionit Evropian.</p>
<p>Neni 19 - Komunikimi me subjektin e të dhënave dhe mënyrat e ushtrimit të të drejtave nga subjekti i të dhënave</p>	<p>Për nenin 19, pika 2, nga projektligji mbetet e paqartë, nëse kur informacioni ofrohet verbalisht a nuk duhet të mbahet procesverbali përkatës.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Në lidhje me këtë koment sqarojmë se dispozitat janë riformuluar në përputhje me GDPR.</p>

<p>1. Kontrolluesi, për aq sa është e mundur, lehtëson ushtrimin e të drejtave nga subjektet e të dhënave sipas neneve 20 deri te 27, duke vendosur një ekuilibër të drejtë midis interesave të subjekteve të të dhënave dhe barrës që përfaqësojnë për kontrolluesin detyrimet sipas këtyre neneve.</p> <p>2. Komunikimi i kontrolluesit me një subjekt të të dhënave, sa i përket përpunimit të të dhënave të tij, zhvillohet në formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, veçanërisht sa i takon informacionit që i drejtohet në mënyrë specifike, një të mituri. Informacionet ofrohen me shkrim, kur është e përshtatshme me mjete elektronike, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave e paraqet kërkesën në formë elektronike. Kur kërkohet nga subjekti i të dhënave, informacioni mund të ofrohet në</p>	<p>Për nenin 19, pika 5, KSHH vlerëson se (konkluzioni) i kontrolluesit duhet të mbështetet në të dhënat e pseudonimizuara.</p>			
--	---	--	--	--

<p>një formë tjetër, përfshirë formën verbale, duke zbatuar paragrafin 3.</p> <p>3. Kur kontrolluesi ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e personit, i cili paraqet kërkesë në kuptim të neneve 20 deri 27, kontrolluesi kërkon informacion shtesë, me qëllim verifikimin e identitetit të subjektit të të dhënave.</p> <p>4. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave në lidhje me përmbushjen e kërkesës, ose arsyen e refuzimit të saj, pa vonesa të paarsyeshme dhe në çdo rast, brenda një muaji nga marrja e kërkesës. Kjo periudhë mund të zgjatet me dy muaj të tjerë kur është e nevojshme, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe numrin e kërkesave të marra. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave për çdo zgjatje afati, brenda një muaji nga marrja e kërkesës, duke dhënë arsyet për vonesën. Në rast refuzimi të përmbushjes së kërkesës, përgjigja përmban informacion</p>				
---	--	--	--	--

<p>lidhur me të drejtën e paraqitjes së ankesës tek Komisioneri.</p> <p>5. Kur të dhënat janë pseudonimizuar, të drejtat sipas neneve 20 deri te 27 nuk mund të ushtrohen, nëse kontrolluesi provon se nuk është në gjendje të identifikojë subjektin e të dhënave.</p> <p>6. Përgjigja ndaj kërkesës së një subjekti të të dhënave sipas neneve 20 deri te 27 ofrohet falas. Kur kërkesat nga një subjekt i të dhënave janë qartazi të pabazuara ose të paarsyeshme, sidomos për shkak të karakterit të tyre të përsëritur, kontrolluesi mund të:</p> <p>a) vendosë një tarifë të arsyeshme, duke marrë parasysh kostot administrative për ofrimin e informacionit ose komunikimit ose për të ndërmarrë veprimin e kërkuar; ose</p> <p>b) refuzojë ndërmarrjen e veprimeve për kërkesën.</p> <p>Kontrolluesi ka barrën për të provuar natyrën qartësisht të</p>				
--	--	--	--	--

<p>pabazuar ose të paarsyeshme të kërkesës.</p>				
<p>Neni 20, pika 1, shkronja “a”</p> <p>1. Kur të dhënat personale janë marrë me bashkëpunimin e subjektit të të dhënave, dhe subjekti i të dhënave nuk e ka informacionin e përmendur më poshtë, atij duhet t’i jepet informacioni si më poshtë:</p> <p>a) identiteti dhe të dhënat e kontaktit të kontrolluesit dhe, kur është e zbatueshme, të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave të kontrolluesit;</p>	<p>Në nenin 20, pika 1, gërma “a” KSHH sugjeron të shtohet dhënia e informacionit mbi kontaktin e ‘përfaqësuesit të kontrolluesit’ si dhe të nëpunësit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave të kontrolluesit.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Ky koment është pranuar dhe dispozita është riformuluar në përputhje me GDPR.</p>
<p>Neni 21 - E drejta për akses</p> <p>Subjekti i të dhënave gëzon të drejtën të marrë nga kontrolluesi, jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, një konfirmim nëse të dhënat personale në lidhje me të janë</p>	<p>Sipas KSHH, duhet të qartësohet se ç’duhet kuptuar me shprehjen “logjikë e vendimmarrjes”. Në ç’baza do të parashikohej ruajtja e të dhënave personale, pa qenë nevoja të përdroreshin kriteret përkatëse?”</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Në lidhje me këtë dispozitë, sqarojmë se ajo është formuluar në përputhje me dispozitën përkatëse të GDPR, si dhe interpretimi i saj duhet të bëhet duke u bazuar në recitalin nr. 63 të saj.</p>

<p>duke u përpunuar apo jo, si dhe, kur është rasti, të ketë akses në të dhënat personale dhe informacionin e mëposhtëm:</p> <p>a) qëllimin(et) e përpunimit, duke përfshirë ekzistencën dhe logjikën e vendimmarrjes dhe profilizimit automatik;</p> <p>b) afatin e parashikuar të ruajtjes së të dhënave personale ose, nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për ta përcaktuar këtë afat;</p> <p>c) bazën ligjore të përpunimit;</p> <p>d) kategoritë e të dhënave personale në fjalë, duke përfshirë, në rastet kur të dhënat personale nuk janë mbledhur nga subjekti i të dhënave, çdo informacion të disponueshëm për burimin e këtyre të dhënave;</p> <p>e) kategoritë e marrësve ose, kur mund të paraqiten rreziqe të veçanta për subjektet e të dhënave, marrësit e të dhënave të përpunuara, përfshirë nëse të dhënat transferohen në vende të huaja dhe nëse po, si sigurohet mbrojtja e duhur;</p>				
--	--	--	--	--

<p>f) ushtrimin e të drejtave sipas neneve 22 deri te 27, dhe të drejtën për të paraqitur ankesë tek Komisioneri.</p> <p>2. Kontrolluesi i ofron falas subjektit të të dhënave, një kopje të listës së kategorive të të dhënave të përpunuara, duke treguar përmbajtjen e secilës kategori që lidhet me subjektin e të dhënave. Ky informacion nuk cenon të drejtat dhe liritë e personave të tjerë. Për çdo kopje të mëvonshme të kërkuar nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi mund të aplikojë një tarifë të arsyeshme në bazë të kostove administrative. Kur subjekti i të dhënave e bën kërkesën me mjete elektronike, dhe nëse nuk kërkohet ndryshe nga subjekti i të dhënave, informacioni ofrohet në formën elektronike të përdorur zakonisht.</p>				
--	--	--	--	--

<p>Neni 23 E drejta për t'u harruar</p> <p>1. Kur kontrolluesi ka bërë publike të dhëna personale dhe detyrohet, në përputhje me nenin 22, t'i fshijë ato, kontrolluesi, duke marrë parasysh teknologjinë e zbatueshme dhe koston e zbatimit, ndërmerr hapa të arsyeshëm, përfshirë masat teknike, për të informuar kontrolluesit që janë duke përpunuar këto të dhëna personale, që subjekti i të dhënave ka kërkuar fshirjen e çdo lidhjeje (linku), ose kopjeje ose replikimi të këtyre të dhënave personale.</p> <p>2. Operatorët e motorëve të kërkimit në internet janë të detyruar, me kërkesë të subjektit të të dhënave, të fshijnë nga rezultatet, që shfaqen pas një kërkimi të kryer në bazë të emrit të subjektit të të dhënave, informacionin, i cili nuk është më aktual me kalimin e kohës por që, kur gjendet, ka një</p>	<p>KSHH sugjeron që të realizohen shtesat në përputhje me nenin 17, pika 1 të Rregullores GDPR. Më konkretisht këto shtesa, i korrespondojnë argumentimeve mbi bazën e të cilave subjekti i të dhënave personale mund të kërkojë nga kontrolluesi fshirjen e të dhënave personale, si një element i domosdoshëm me të drejtën për t'u harruar. Më konkretisht, sugjerojmë shtesën e këtyre argumentimeve: “(i) të dhënat personale nuk janë më të nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat janë mbledhur ose përpunuar; (ii) subjekti i të dhënave tërheq pëlqimin mbi të cilin bazohet përpunimi, dhe kur nuk ka bazë tjetër ligjore për përpunimin; (iii) subjekti i të dhënave kundërshton përpunimin në përputhje me nenin 24 dhe nuk ka arsye legjitime mbizotëruese për përpunimin; (iv) të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme”.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Në lidhje me këtë koment sqarojmë se e drejta për t'u harruar është pjesë e së drejtës për fshirje. Në këto kushte ky nen interpretohet dhe zbatohet në përputhje me të drejtën për fshirje. Dispozitat janë riformuluar në përputhje me GDPR dhe komentet e Komisionit Evropian.</p>
--	---	---	-----------------------	--

<p>ndikim negativ të konsiderueshëm në reputacionin e subjektit të të dhënave.</p>				
<p>Neni 24 E drejta për të bllokuar përpunimin</p> <p>1. Kur saktësia ose ligjshmëria e përpunimit kundërshtohet nga subjekti i të dhënave, ai gëzon të drejtën t'i kërkojë kontrolluesit bllokimin e përpunimit, derisa për çështjen në fjalë të merret një vendim nga autoritetet kompetente. Nëse kontrolluesi refuzon kërkesën, subjekti i të dhënave mund të paraqesë ankesë tek Komisioneri dhe të kërkojë marrjen e një vendimi paraprak për bllokimin e përpunimit; Komisioneri lëshon urdhër paraprak bllokimi sipas nenit 90 jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja e kërkesës, nëse kjo është e nevojshme dhe proporcionale.</p>	<p>KSSH sugjerojmë shtimin e procedurave, që të pasqyrohet si veprohet kur Komisioneri vendos refuzimin e bllokimit.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Sqarojmë se dispozitat janë formuluar në përputhje me GDPR.</p>

<p>2. Bllokimi i përpunimit nënkupton që të dhënat personale, me përjashtim të ruajtjes, përpunohen vetëm pas marrjes së pëlqimit të subjektit të të dhënave, për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore, për mbrojtjen e të drejtave të një personi tjetër fizik ose juridik të cilat kanë përparësi mbi të drejtat e subjektit të të dhënave ose për interes të rëndësishëm publik.</p> <p>3. Kur të dhënat bllokohen, kontrolluesi informon të gjithë marrësit të cilëve ua ka përhapur të dhënat në fjalë përpara bllokimit.</p>				
<p>Neni 26 E drejta për të kundërshtuar</p> <p>1. Subjekti i të dhënave gëzon të drejtën të kundërshtojë në çdo kohë, për arsye që lidhen me situatën e tij të veçantë, përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, në bazë të gërmave (e) dhe (f) të</p>	<p>Lidhur me kete nen KSHH, parashtron pyetjen nëse do të ishte e justifikueshme që kontrolluesi të mos përpunonte të dhënat personale, duke u mbështetur kryesisht në këtë apo atë pretendim ligjor?</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Sqarojmë se dispozitat janë formuluar në përputhje me GDPR.</p>

<p>nenit 7, përfshirë profilizimin bazuar në ato dispozita. Kjo vlen përkatësisht për përpunimin e të dhënave sensitive ose penale.</p> <p>2. Kur të dhënat personale përpunohen për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, subjekti i të dhënave gëzon të drejtën të kundërshtojë në çdo kohë, pa pasur nevojë të japë ndonjë arsye, përpunimin e të dhënave të tij personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, që përfshin profilizimin për aq sa është i lidhur me këtë marketing të drejtpërdrejtë.</p> <p>3. E drejta për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e përmendura në nenin 16 kufizohet në ato veprime përpunimi, të cilat nuk janë të nevojshme për kryerjen e një detyre me interes publik.</p> <p>4. Në vijim të një kundërshtimi sipas paragrafëve 1 deri në 3, kontrolluesi nuk përpunon më të dhëna personale, përveç nëse</p>				
--	--	--	--	--

<p>tregon arsye të forta legjitime për përpunimin, të cilat kanë përparësi mbi interesat, të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave, veçanërisht kur kanë të bëjnë me ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.</p>				
<p>Neni 28 Kufizimet e të drejtave të subjekteve të të dhënave</p> <p>Fusha e zbatimit të të drejtave të parashikuara në nenet 20 deri 27 dhe të detyrimeve që burojnë për kontrolluesit, si dhe neni 6, për aq sa dispozitat e tij korrespondojnë me të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në nenet 20 deri në 27, mund të kufizohen me ligj, nëse është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e trazirave ose veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për</p>	<p>Mbi “kufizimet e të drejtave të subjekteve të të dhënave”, KSHH sugjeron shtimin e një paragrafi 2) me përmbajtjen e mëposhtme: “Në veçanti, çdo masë legjislative e përmendur në paragrafin 1 do të përmbajë dispozita specifike të paktën, aty ku është e nevojshme, në lidhje me: qëllimet e përpunimit ose kategoritë e përpunimit; (i) kategoritë e të dhënave personale; (ii) shtrirja e kufizimeve të vendosura; (iii) masat mbrojtëse për të parandaluar abuzimin ose aksesin ose transferimin e paligjshëm; (iv) specifikimin e kontrolluesit ose kategorive të kontrolluesve; (v) periudhat e ruajtjes dhe masat mbrojtëse të zbatueshme duke marrë parasysh natyrën, qëllimin dhe qëllimet e</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Sa i përket këtij komenti sqarojmë se ai është pranuar dhe dispozita është riformuluar në përputhje me GDPR.</p>

<p>mbrojtjen e të drejtave dhe lirisë së personave të tjerë.</p>	<p>përpunimit ose kategoritë e përpunimit; (vi) rreziqet për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave; dhe (vii) të drejtën e subjekteve të të dhënave për t'u informuar për kufizimin, përveç rasteve kur kjo mund të jetë e dëmshme për qëllimin e kufizimit”.</p>			
<p>Neni 29, pika 2</p> <p>2. Kontrolluesi reflekton mbi mënyrën e vënies në zbatim të konceptit të privatësisë në projektim (privacy by design) në përputhje me nenin 41 në proceset e tij përpunuese dhe se si mund të administrohet koncepti i privatësisë në mënyrë të paracaktuar (privacy by default) në përputhje me këtë nen. Gjithashtu, emërimi i një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave merret në konsideratë pavarësisht kritereve të përcaktuara në nenin 43, veçanërisht kur proceset e përpunimit të kontrolluesit përmbajnë elemente të tjerë të</p>	<p>Shprehja ‘kontrolluesi reflekton’ të bëhet më e qartë, sepse ndryshe mundet që termi ‘reflekton’ të shoqërohet me element subjektivë.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Në vijim të këtij komenti, sqarohet se dispozita është riformuluar.</p>

<p>rëndësishëm rreziku, përveç atyre të përmendur në paragrafin 1 të nenit 43.</p>				
<p>Neni 38 - Detyrimi për njoftim</p> <p>1. Çdo kontrollues njofton Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Njoftimi bëhet për çdo qëllim të përpunimit dhe përpara se kontrolluesi të fillojë të përpunojë të dhënat, ose kur parashikohet një ndryshim në veprimet e përpunimit.</p> <p>2. Kontrolluesit përjashtohen nga detyrimi për njoftim, sipas paragrafit 1, kur</p> <p>a) përpunimi kryhet për një regjistër, i cili sipas ligjit ose akteve nënligjore, ofron informacion për publikun në përgjithësi, ose,</p> <p>b) të dhënat përpunohen në interes të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesave ekonomike ose financiare të</p>	<p>Sa i përket këtij neni KSHH, vlerëson se mbetet e paqartë se në ç'mënyrë duhet bërë njoftimi, cili është efekti (ose përse duhet bërë njoftimi) para përpunimit të të dhënave.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Në lidhje me këtë koment theksojmë se neni 38 është hequr nga përmbajtja e projektligjit.</p>

<p>shtetit, parandalimit ose ndjekjes së veprave penale, ose,</p> <p>c) në raste të tjera të përpunimit që janë deklaruar të përjashtuara nga detyrimi për njoftim me anë të një vendimi të publikuar nga Komisioneri.</p>				
<p>Neni 44, pika 4</p> <p>4. Pasi teksti i një kodi të paraqitur miratohet nga Komisioneri, zotëruesi i kodit propozon një nga organet monitoruese, të akredituara nga Komisioneri sipas nenit 45, për monitorimin e zbatimit të këtij kodi. Kodi mund të vihet në zbatim sapo Komisioneri të emërojë një organ specifik monitorimi për monitorimin e këtij kodi.</p>	<p>Duhet të qartësohet se çfarë cilësie dhe ç'pozicion duhet të kishte organi monitorues që do të akreditonte Komisioneri.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Në lidhje me këto komente silllet në vëmendje se dispozitat janë hartuar në përputhje me dispozitat e GDPR dhe duhet të interpretohen në përputhje me recitalet 98 dhe 99 të GDPR.</p>
<p>Neni 45</p> <p>Organet monitoruese</p> <p>1. Subjektet e sektorit privat mund të akreditohen nga Komisioneri për monitorimin e</p>	<p>Referuar nenit 45 të projektligjit, KSHH vlerëson se duhet të qartësohet si do të realizohet vlerësimi nga Komisioneri, d.m.th., mbi ç'baza dhe mbështetur në cilat kritere. Ndoshta do të ishte më e përshtatshme që këto të dhëna të</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Në lidhje me këto komente silllet në vëmendje se dispozitat janë hartuar në përputhje me dispozitat e GDPR dhe duhet të interpretohen në përputhje me recitalet 98 dhe 99 të GDPR.</p>

<p>përputhshmërisë me kodin e sjelljes, kur subjekti</p> <p>a) demonstroi pavarësinë dhe ekspertizën e tij në lidhje me çështjen objekt rregullimi nga kodi, në mënyrë të kënaqshme për Komisionerin;</p> <p>b) përcakton procedura që i lejojnë atij të vlerësojë aftësinë e kontrolluesve dhe përpunuesve në fjalë për zbatimin e kodit, monitorimin e përputhshmërisë së tyre me dispozitat e tij dhe për të rishikuar në mënyrë periodike funksionimin e tij;</p> <p>c) përcakton procedura dhe struktura për të trajtuar ankesat në lidhje me shkeljet e kodit ose mënyrën në të cilën është zbatuar ose po zbatohet kodi nga një kontrollues ose përpunues, dhe për t'i bërë ato procedura dhe struktura transparente për subjektet e të dhënave dhe publikun;</p> <p>d) demonstroi në një nivel të kënaqshëm për Komisionerin që përgjegjësitë dhe detyrat e tij nuk shkaktojnë konflikt interesash.</p>	<p>përcaktohet me ligj dhe jo nga Komisioneri. Duke qenë se në nenin 46 është parashikuar termi 'certifikimi' njëlloj me terminologjinë e përdorur edhe nga ana e Rregullores GDPR, sugjerojmë që edhe në nenin 45, pika 1), termi 'akreditim' të zëvendësohet me atë 'certifikim'.</p>			
---	---	--	--	--

<p>2. Komisioneri përcakton me udhëzim kriteret për akreditim si organ monitorues.</p> <p>3. Pa cenuar detyrat dhe kompetencat e Komisionerit, organi monitorues, në përputhje me masat e duhura mbrojtëse, vepron në rastet e shkeljes së kodit nga një kontrollues ose përpunues, i cili ka marrë përsipër t'i përmbahet kodit. Këto masa përfshijnë pezullimin ose përjashtimin e kontrolluesit ose përpunuesit në fjalë nga kodi. Organi monitorues informon Komisionerin për këto masa dhe për arsyet që çuan në ndërmarrjen e tyre. Komisioneri mund t'i anulojë këto masa në çdo moment.</p> <p>4. Komisioneri revokon akreditimin e një organi monitorues nëse nuk plotësohen, ose nuk plotësohen në vijimësi kushtet për akreditim ose nëse masat e marra nga subjekti në fjalë shkelin këtë ligj.</p>				
---	--	--	--	--

<p>Neni 53</p> <p>Dallimi dhe cilësia e të dhënave</p> <p>1. Për aq sa është e mundur, bëhet një dallim i qartë midis të dhënave personale të kategorive të ndryshme të subjekteve të të dhënave, si më poshtë:</p> <p>a) personat në lidhje me të cilët ka arsye të forta për të besuar se ata kanë kryer ose do të kryejnë një veprë penale;</p> <p>b) personat e dënuar për një veprë penale;</p> <p>c) viktimat të një veprë penale ose persona për të cilët disa fakte japin arsye për të besuar se ata janë viktimat të një veprë penale; dhe</p> <p>d) persona të tjerë të lidhur me një veprë penale, siç janë personat që mund të thirren për të dëshmuar, personat që mund të japin informacione për veprat penale, ose kontaktet ose bashkëpunëtorët e njërit prej personave të përmendur në pikat (a) dhe (b) të këtij paragrafi.</p>	<p>Është e diskutueshme përmbajtja e pikës 1, shkronja a), ku bëhet fjalë për personat kur ka ‘arsye të forta’ për të besuar se ata kanë kryer ose do të kryejnë një veprë penale. Ky përfrizim mund të bjerë ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë. I diskutueshëm, mendojmë se është edhe formulimi i shkronjës c), ku thuhet: “japin arsye për të besuar”. Po ashtu edhe për shkronjën d). Mbetet e paqartë se cili është institucioni përgjegjës për të realizuar këtë dallim. Në këndvështrimin tonë, kjo lidhet edhe me shprehjen ‘vlerësime personale’.</p>	<p>Komiteti Shqiptar i Helsinkit</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Në lidhje me këtë dispozitë, sqarojmë se ajo është riformuluar në përputhje me GDPR dhe Kodin e Procedurave Penale.</p>
---	--	---	-----------------------	--

<p>2. Të dhënat personale të bazuara në fakte duhet të dallohen, për aq sa është e mundur, nga të dhënat personale të bazuara në vlerësime personale. Të dhënat personale të bazuara në vlerësime personale shënohen në përputhje me rrethanat, dhe arsyet mund të shtohen për të lehtësuar të kuptuarin e një vlerësimi.</p> <p>3. Të dhënat personale të pasakta ose të paplota, ose të dhënat që nuk janë më të përditësuara ose duhet të ishin fshirë, nuk transferohen dhe as nuk vihen në dispozicion, veçanërisht për efekt të ruajtjes automatike nga sistemet e arkivimit. Për këtë qëllim, autoriteti kompetent, verifikon, për aq sa është e mundur, cilësinë e të dhënave para transmetimit. Të dhënat personale të mbajtura gati për ruajtje automatike mbahen të plota dhe të përditësuara në çdo kohë.</p> <p>4. Për aq sa është e mundur, së bashku me çdo transmetim të të</p>				
---	--	--	--	--

<p>dhënave personale, jepen informacione shtesë që i japin mundësi marrësit që të vlerësojë përditësimin, korrektësinë, plotësinë dhe besueshmërinë e të dhënave personale të transmetuara.</p> <p>5. Nëse rezulton se janë transmetuar të dhëna personale të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e paragrafit 3, autoriteti kompetent për transmetimin ose autoriteti kompetent që mban sistemin e arkivimit e njofton pa vonesa marrësin. Marrësi fshin menjëherë të dhënat që janë transmetuar në mënyrë të paligjshme, korrigjon të dhënat e pasakta, plotëson të dhënat jo të plota ose kufizon menjëherë përpunimin.</p> <p>6. Nëse autoriteti kompetent pritës ka arsye të besojë se të dhënat personale të transmetuara janë të pasakta ose të papërditësuara ose duhet të fshihen, ose që përpunimi i tyre do të duhej të kufizohej, ai njofton menjëherë autoritetin</p>				
--	--	--	--	--

kompetent transmetues. Ky i fundit merr menjëherë masat e nevojshme.				
Neni 81, pika 2 2. Personat që kanë mbajtur detyrën e anëtarit të Këshillit të Ministrave ose anëtarit të Kuvendit gjatë katër viteve të fundit nuk mund të zgjidhen në pozicionin e Komisionerit.	Togfjalëshi ‘anëtari i Kuvendit’ të qartësohet, nëse kemi të bëjmë me termin ‘deputet’.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Pranuar	Në lidhje me këto koment sqarojmë se togfjalëshi “anëtar i Kuvendit” është zëvendësuar me termin “deputet”
Neni 84, shkronja “q” 1. Pavarësisht detyrave të tjera të përcaktuara sipas këtij Ligji, Komisioneri është përgjegjës për: q) vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë;	KSHH propozon që në nenin 84, shkronja “q”, të shtohet togfjalëshi ‘së tij’ (veprimtarisë së tij).	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Pranuar	Sa i përket këtij komenti, sqarojmë se kjo dispozitë është hequr nga përmbajtja e projektligjit.
Mbi masën dhe proporcionitetin e sanksioneve	- masat e avancuara të ndëshkimeve financiare karshi këtyre subjekteve që ato janë subjekte të së drejtës pavarësisht nëse ato janë publike, kjo do të shkonte pa	Shoqata “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë” Shoqata Shqiptare e Bankave Jonida Borici	Refuzuar	Në lidhje me sanksionet administrative për shkeljen e ligjit, duhet theksuar se gjatë gjithë fazës së hartimit të këtij projektligji dhe bashkërendimit të tij me institucionet shtetërore, Komisionin Evropian, si dhe në vijim të komenteve të përcjella nga grupet e interesit, dispozita

	<p>diskutim penalizmi publik pra dy miliardë ose me shumë;</p> <p>- problemin e transferimit të të dhënave kur nuk gjenden rregullime të mjaftueshme për aq sa mund të konsultoj nuk marr përsipër te kem mendim të kualifikuar mbi këtë pohim pasi transferimi i të dhënave duket sikur del jashtë juridiksionit, mbulimit ndoshta dhe fuqisë kontrolluese që mund të këtë shteti shqiptar dhe mendoj që për ta parandaluar i vetmi instrument i mundshëm do të duhej të ishte përforcimi i konsentit nga ai që disponon të dhënat nga subjekti nga individ që në çdo rast transaksion ku ndërverpohet me të dhënat personale.</p> <p>gjoba deri në 2 milion euro fillon nga 10 milion euro deri në 4 % nëse 4 % është më i madh se 10 milion euroshi, kështu është një element i</p>	<p>Përfaqësuese nga Reforma ne Drejtësi</p> <p>Drejtues i çështjeve të informimit publik.</p> <p>Gerti Shella.</p> <p>Shoqata Shqiptare e Turizmit.</p> <p>Artani nga Shoqata Shqiptare e Biznesit</p> <p>Xheko Imperial nga Shoqata Pronës Turke Shqiptare.</p> <p>Bashkimi Teknik i Shqipërisë</p>	<p>përkatëse ka ndryshuar. Fillimisht janë përcaktuar sanksione të njëjta me ato të parashikuara në GDPR. Megjithatë, në vijim të komenteve të përcjella nga grupet e interesit, sanksionet administrative u rishikuan duke u bazuar në të dhënat e disponueshme nga INSTAT dhe EUROSTAT mbi pagën mesatare, si një komponent i rëndësishëm i aftësisë paguese të subjekteve në caktimin e masës së sanksionit administrativ.</p> <p>Sipas INSTAT paga mesatare bruto në Shqipëri¹ në vitin 2021 për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të katërt 2021, ishte 59.565 lekë. Kjo pagë e llogaritur në neto shkon në masën në masën 49.050 lekë ose 406 Euro². Ndërkohë sipas EUROSTAT në total, paga mesatare neto vjetore në 27 vendet e Bashkimit Europian ishte 14.436³ Euro, pra 1.203 Euro në muaj.</p> <p>Siç shihet edhe më lart paga mesatare neto në muaj në Bashkimin Europian,</p>
--	--	---	---

¹ http://www.instat.gov.al/media/9660/pagat_press_release-t4_-2021-altcom.pdf

² Llogaritur sipas kursit të këmbimit mesatar të muajt dhjetor 2021 aksesuar në https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

³ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/earn_nt_net/default/table?lang=en

	<p>prekshëm dhe shume i rëndësishëm për ne.</p>		<p>është përafërsisht 3 herë më e lartë se paga mesatare neto në muaj në Republikën e Shqipërisë. Në këto kushte, ky raport u reflektua edhe në përcaktimin e masës së sanksioneve administrative të parashikuara nga ligji, në variantin e projektligjit i cili dërgua për bashkërendim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p>Megjithatë, theksojmë se masa e sanksioneve ndryshoi sërish pas shqyrtimit të projektligjit nga Komisioni Europian. Në komunikimin elektronik, si dhe në takimin online të datës 26.01.2023 u theksua se GDPR nuk vendos masa fikse të sanksioneve, por vetëm kufij maksimal. Brenda këtij kufiri, gjoba përkatëse përcaktohet përmes një vlerësimi global duke parë një sërë faktorësh si rëndësia e shkeljes, faji, kohëzgjatja e shkeljes, shkeljet e mëparshme, masat e marra për të zbutur çdo dëm, etj. Në përgjithësi, GDPR kërkon që gjobat të jenë parandaluese, por edhe proporcionale (me shkeljen dhe në dritën e efektit që gjoba mund të ketë te subjekti). Kjo do të thotë se në praktikë gjobat - nëse vendosen - janë zakonisht</p>
--	---	--	--

				<p>shumë më të ulëta se tavanet. Bordi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave ka përgatitur udhëzime për këtë çështje.</p> <p>Gjithashtu, në këto komunikime dhe takime u theksua edhe rëndësia e unifikimit të masave administrative për shkelje të njëjta në vende të ndryshme, duke theksuar se operatorë që veprojnë në vende të ndryshme duhet të marrin të njëjtin sanksion për të njëjtën shkelje. Për më tepër, e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është një e drejtë universale e cila duhet t'i garantohet njësoj qytetarëve shqiptarë si qytetarëve evropian. Parashikimi i kufijve të ndryshëm nga ato të GDPR në Republikën e Shqipërisë, relativizon rëndësinë e kësaj të drejte për shtetasit shqiptarë.</p> <p>Në këto kushte, dispozitat në lidhje me masat administrative janë ripunuar me qëllim reflektimin e komenteve të Komisionit Evropian.</p>
Mbi hyrjen në fuqi të ligjit	Rferuar praktikës së ndjekur nga vendet e BE, Shoqata Shqiptare e Bankave vlerëson që projektligji të	Shoqata Shqiptare Bankave.	Refuzuar	Komenti nuk është pranuar në vijim të kërkesës së Komisionerit, në vijim të të cilit është parashikuar hyrja në fuqi e disa

	hyjë në fuqi në të njëjtën kohë duke zbatuar afatin 2 vjeçar.			dispozitave të ligjit 2 vite pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare, e cila vlerësohet si një kohë e nevojshme për përgatitjen e zbatimit të tyre nga ana e kontrolluesve dhe përpunuesve. Sillet në vëmendje se kjo dispozitë ka ndryshuar disa herë në draft, por në përfundim, në vijim të kërkesës së KDIMDHP është parashikuar që ligji të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe përjashtimisht, pika 3 e nenit 29, neni 31, 32, 35, 36, 64, 65 dhe pikat 2, 3 dhe 5 të nenit 67, të hyjnë në fuqi 2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Mbi dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale	Ligji kishte një metodë sa i përket dhënies së pëlqimit dhe normalisht bizneset janë pak konfuzë te kjo pjesë sepse qoftë edhe të dhënat që deklarohen për marrjen e një vendi pune apo diçka tjetër nuk janë shume të qartë çfarë mund të quhet pëlqim, pëlqim mund të quhet dhe tundja e kokës në disa raste ose banka mund të marrë dhe një nënshkrim	Bashkimi Tregtar i Shqipërisë	Pranuar	Dispozita është reflektuar në përputhje me parashikimet e GDPR